

**LIGJI Nr. 05/L-049**

**PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR**

**KAPITULLI I  
DISPOZITAT THEMELORE**

**Neni 1  
Fushëveprimi dhe qëllimi i ligjit**

Ky ligj përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e mëposhtme të përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Agjencia** - do të thotë Agjenci për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar;

1.2. **Konfiskimi** - do të thotë marrje e përhershme e pasurisë, të urdhëruar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

1.3. **Qeveria** - nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës;

1.4. **Ministria** - nënkupton Ministrinë e Drejtësisë;

1.5. **Kodi** - nënkupton Kodin e Procedurës Penale;

1.6. **Pasuri** - nënkupton çdo fond apo pasuri, përfshirë, por jo të kufizuara në pasuri financiare, burime ekonomike, prona të çfarëdo lloji, të prekshme apo të paprekshme, të luajtshme apo të paluajtshme, dhe dokumente ligjore apo instrumente të çfarëdo forme, përfshirë ato elektronike apo digjitale, që dëshmojnë tituj pronësie apo interes në fonde të tilla apo pasuri tjera, përfshirë, por jo të kufizuara në kreditë bankare, çeqe udhëtarësh, çeqe bankare, urdhra për pagesë paraje, aksione, letra me vlerë, bono, drafte, apo letra krediti, dhe çfarëdo interesi, dividenda apo të ardhura tjera në to, apo vlera që rrjedhin apo të gjeneruara nga fonde të tilla apo pasuri tjera, të përvetësuara në mënyrë të

drejtpërdrejtë, apo të tërthortë përmes veprës penale dhe çfarëdo të ardhurash në të cilat është shndërruar apo përzier dhe fondet apo pronat terroriste;

1.7. **Sekuestrim** - do të thotë marrja e përkohshme e sendit në bazë të vendimit të gjykatës apo organit kompetent, në pajtim me ligjin;

1.8. **Administrimi me Pasurinë** - nënkupton disponimin e plotë në përputhje me dispozitat e përcaktuara me këtë ligj që Agjencia bën me pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke përfshirë magazinimin, ruajtjen e përkohshme, shitjen e pasurisë, dhënien me qira, dhënien në shfrytëzim pa kompensim dhe vlerësimin e vlerës së pasurisë së konfiskuar në pajtim me ligjin, derdhjen e mjeteve në të holla të fituara nga shitja e pasurisë së konfiskuar në pajtim me ligjin dhe çdo lloj aktiviteti tjetër të nevojshëm për të ruajtur dhe mbajtur vlerën e pasurisë;

1.9. **Kompetencat e zgjeruara të konfiskimit** - janë masat për konfiskimin e pasurisë sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale;

1.10. **Pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit** - është pasuria që është në pronësi të të pandehurit ose që mbahet në emër të të pandehurit, e cila i nënshtrohet urdhrin ndalues ose sekuestrimit sipas legjislacionit në fuqi;

1.11. **Prona Terroriste**- nënkupton:

1.11.1. të ardhurat nga kryerja e një akti terrorist;

1.11.2. prona e cila ka qenë, është, ose ka për qëllim që të përdoret për kryerjen e një akti terrorist;

1.11.3. prona e cila ka qenë, është, ose ka për qëllim që të përdoret nga një organizatë terroriste;

1.11.4. prona në pronësi ose në kontroll, apo për llogari të një organizate terroriste; ose

1.11.5. prona e cila është mbledhur me qëllim të mbështetjes së një organizate terroriste ose për financimin e një akti terrorist.

### **Neni 3 Parimet e Ligjit**

Gjatë veprimit dhe administrimit me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar, veprohet në pajtim me parimet e ligjshmërisë, ekonomizimit, efikasitetit, transparencës, veprimit me kujdesin e nikoqirit të mirë me përgjegjësi dhe profesionalizëm.

## KAPITULLI II FUNKSIONET E AGJENCISË

### Neni 4 Funkcionet e Agjencisë

1. Në kuadër të drejtave dhe detyrave të parapara me ligj, Agjencia ushtron funksionet si në vijim:

1.1. administron me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar të përdorura për, apo të përfituara nga vepra penale, përfshirë pasurinë e terrorizmit, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore;

1.2. ekzekuton urdhrin e gjykatës për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi;

1.3. ekzekuton aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës, sipas legjislacionit në fuqi, mund të bëjë shitjen e sendeve duke derdhur të ardhurat e grumbulluara nga shitja në buxhetin e Kosovës ose dorëzimin e pasurive për shfrytëzim nga Qeveria;

1.4. bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, si dhe përcakton mënyrën e ruajtjes së kësaj pasurie;

1.5. mbanë evidencat për pasurinë të cilën e administron dhe për vendimet gjyqësore në të cilat është vendosur për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar;

1.6. përcakton mënyrën e ruajtjes së vlerës së pasurisë nën administrim;

1.7. merr pjesë në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare për të gjitha rastet që përfshijnë pasurinë e sekuestruar dhe konfiskuar, duke administruar pasurinë e sekuestruar apo konfiskuar në bazë të kërkesës së bërë nga një shtet tjetër;

1.8. merr pjesë në hartimin e programit të aftësimin të nëpunësve shtetëror lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë të përfituar me vepër penale;

1.9. sipas nevojës, ndihmon në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë;

1.10. mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, sipas vendimit të gjykatës kompetente;

1.11. administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik;

1.12. ofron këshilla për Prokurorinë, Gjykatën dhe institucionet tjera mbi natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar, me qëllim të ofrimit të ndihmës për planifikimin sekuestrimeve, apo konfiskimeve të mundshme;

1.13. lidhë Memorandume të Bashkëpunimit me organet partnere dhe institucionet

relevante për t'u dakorduar për marrëdhëniet dhe përgjegjësitë, si dhe për të rritur performancën, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.14. kryen edhe punë të tjera të besuara me ligj.

### **KAPITULLI III STRUKTURA E AGJENCISË DHE EVIDENCA**

#### **Neni 5 Statusi Juridik i Agjencisë**

1. Agjencia është organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Agjencia ka statusin e personit juridik, shenjën e vet identifikuese dhe ka selinë në Prishtinë.
3. Agjencia vepron si mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm i administrimit profesional dhe të kujdesit të nikoqirit të mirë për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar në Republikën e Kosovës dhe nga detyrimet e Republikës në raport me shtetet tjera.
4. Të gjitha funksionet në lidhje me administrimin e pasurisë, Agjencia i kryen në bazë të vendimit të gjykatës ose sipas detyrës zyrtare (ex officio).

#### **Neni 6 Pavarësia e Agjencisë**

1. Agjencia është e pavarur në kryerjen e funksionit të vet në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.
2. Asnjë organ ose institucion publik nuk ka të drejtë që në çfarëdo mënyre të ndikojë në punën e Agjencisë.

#### **Neni 7 Udhëheqja**

1. Me punën e Agjencisë udhëheq Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë (në tekstin e mëtejshëm: Drejtori i Përgjithshëm).
2. Drejtori i Përgjithshëm emërohet në bazë të konkursit të hapur sipas procedurës së paraparë me dispozitat për emërimin në pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
3. Drejtori i Përgjithshëm nuk mundet të jetë anëtar i organit të partisë politike.

#### **Neni 8 Autorizimet e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm udhëheqë, përfaqëson dhe prezanton Agjencinë, organizon dhe

siguron kryerjen e ligjshme, të drejtë dhe efikase të punëve nga kompetenca e Agjencisë.

2. Drejtori i Përgjithshëm vendosë për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në Agjenci, në pajtim me ligjin.

3. Për punën e tij dhe punën e Agjencisë, Drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet Ministrit të Drejtësisë.

4. Drejtori i Përgjithshëm ka pozitën e lartë drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat për shërbyesit civil.

5. Nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe, dispozitat për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për kushtet e emërimit, procedurës së emërimit, riemërimit, pushimit të funksionit, drejtave dhe detyrave tjera për pozitën e larta drejtuese në Shërbimin Civil, përshtatshmërisht zbatohen edhe për Drejtorin e Përgjithshëm.

6. Drejtori i Përgjithshëm mund të autorizojë të punësuarin në Agjenci që të nënshkruajë akte, të vendosë për çështje të caktuara dhe të kryejë punë të tjera nga kompetenca e Agjencisë, përveç për akte dhe punë të cilat në pajtim me ligjin janë nën kompetencën ekskluzive të Drejtorit të Përgjithshëm.

## **Neni 9**

### **Përcaktimi i organizimit të brendshëm të Agjencisë**

1. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës së Agjencisë përcaktohet me Rregulloren përkatëse të Agjencisë, e cila miratohet nga Ministri i Drejtësisë dhe përfshihet si kre i veçantë në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Për kryerjen e punëve dhe detyrave nga kompetenca e Agjencisë organizohen këto njësi themelore organizative:

2.1. drejtoratet; dhe

2.2. sektorët.

3. Në punën, organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, si në të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e nëpunësve civil në Agjenci zbatohen dispozitat për administratën shtetërore dhe dispozitat për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa në vendosjen e çështjeve administrative zbatohen dispozitat për procedurën administrative.

## **Neni 10**

### **Aftësimi profesional**

Të punësuarit në Agjenci kanë të drejtë dhe detyrim në edukim dhe trajnim, në pajtim me programin dhe planin vjetor të cilin me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm e miraton Ministri i Drejtësisë.

### **Neni 11** **Raportimi për Punën e Agjencisë**

1. Raportin e punës, Agjencia është e detyruar që njëherë në vit t'ia dërgojë Ministrit të Drejtësisë.
  
2. Me kërkesën e gjykatës, prokurorisë ose të organit kompetent, apo me vetiniciativë, Agjencioni dërgon raport, apo njoftim për veprimin me lëndën konkrete, apo për grup të caktuar lëndësh, për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, përfshirë edhe raportimin statistikorë për qëllime të analizimit të punës së gjyqësorit, apo hartimin e strategjive në fushën e sundimit të ligjit me ndikim të drejt për drejtë apo të tërthortë në çështjet e sekuestrimit dhe konfiskimit. Raportimi statistikor duhet të pasqyrojë qartë numrin dhe llojin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

### **Neni 12** **Evidenca për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar**

1. Agjencia mbanë evidencën për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar me të cilën administron, në evidencë shënohen të dhënat për:
  - 1.1. numri i vendimit gjyqësorë;
  - 1.2. emri i gjykatës;
  - 1.3. baza dhe afati i sekuestrimit ose konfiskimit;
  - 1.4. të dhënat për pasurinë, vlera e vlerësuar e pasurisë;
  - 1.5. emri, mbiemri, numri personal identifikues (NPI), dhe adresa e personit fizik, përkatësisht emri, selia dhe numrin e regjistrimit të biznesit (NRB), të subjektit juridik nga i cili është sekuestruar ose konfiskuar pasuria nëse figurojnë në vendimin e Gjykatës;
  - 1.6. vendi ku mbahet pasuria;
  - 1.7. koha kur është inspektuar për herën e fundit;
  - 1.8. cilat janë nevojat e veçanta për administrim dhe si po adresohen ato nevoja nga Agjencia;
  - 1.9. cilat janë shpenzimet për administrimin dhe mirëmbajtjen e kësaj pasurie;
  - 1.10. detaje mbi palët e treta që kanë interes mbi këtë pasuri;
  - 1.11. detaje mbi çdo person tjetër që ka një interes në atë pasuri, përveç atij të cilit i është marrë pasuria;
  - 1.12. të dhëna mbi kërkesat ndërkombëtare mbi atë pasuri;
  - 1.13. detaje tjera që mund të jenë të nevojshme për institucionet dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi.

## **KAPITULLI IV**

### **SHKËMBIMI I INFORMATAVE DHE BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

#### **Neni 13**

##### **Detyrimet e organeve dhe të institucioneve publike**

1. Gjykata ia dërgon Agjencisë vendimin për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, në ditën e marrjes së vendimit ose ditën vijuese të punës, por në asnjë rast jo më vonë se afatet e përcaktuara me dispozitat e Kodit.
2. Agjencia mund të kërkojë nga gjykata, prokurori i shtetit dhe organet e institucionet tjera dërgimin e të dhënave të caktuara, apo informacione të cilat i nevojiten për kryerjen e punëve, ndërsa institucioneve përkatëse u kërkohet të përgjigjen brenda afatit të kërkuar, të dërgojnë përgjigje dhe të veprojnë në pajtim me kërkesën e Agjencisë.

#### **Neni 14**

##### **Dhënia dhe Shkëmbimi i Informacioneve**

1. Çdo person fizik, apo juridik, të cilit i është sekuestruar pasuria, apo personat e tretë fizikë apo juridikë, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të informohet për pasuritë e tyre të sekuestruara të cilat janë nën administrimin e Agjencisë. Kërkesa e tillë i drejtohet gjykatës kompetente, e cila mund të urdhërojë Agjencinë për llojin e informacionit që mund t'i ofrohet palës kërkuese.
2. Secili zyrtar i Agjencisë është i detyruar që t'i ruaj fshehtësitë për të gjitha të dhënat, të cilat konsiderohen të mbrojtura me ligj përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale. Informatat e caktuara mund të zbulohen vetëm në përputhje me dispozitat përkatëse në lidhje me qasjen në dokumentet zyrtare.
3. Nëse gjatë administrimit të pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, Agjencia zbulon se pasuria e tillë është përdoruar drejtpërdrejt, apo tërthorazi për ndonjë vepër penale, apo nëse gjatë administrimit zbulon prova tjera që e lidhin këtë pasuri me veprën apo veprat tjera penale, informatat e tilla duhet të dorëzohen menjëherë pranë prokurorit kompetent.
4. Në rastet kur një autoritet kompetent në Republikën e Kosovës, posedon informata të cilat do të asistonin Agjencinë në kryerjen e funksioneve të saj sipas këtij Ligji, do t'ia transmetojë informatat e tilla Agjencisë, pavarësisht rregullave të konfidencialitetit. Agjencia mund të nënshkruaj një Memorandum Mirëkuptimi për rregullimin e shkëmbimeve të tilla të informatave.

#### **Neni 15**

##### **Bashkëpunimi Ndërkombëtar**

1. Në rastet kur në Republikën e Kosovës pranohet një kërkesë nga një shtet tjetër në lidhje me pasuritë, dhe kur gjykatat në Kosovë e kanë pranuar kërkesën dhe pasuritë që përbëjnë subjektin e kërkesës janë transferuar në Agjenci për t'u administruar, Agjencia do të ketë përgjegjësinë për ato pasuri njësoj sikur çështja do të kishte nisur në Republikën e Kosovës.
2. Bashkëpunimi ndërkombëtar në administrimin me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar realizohet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.
3. Nëse marrëveshja ndërkombëtare nuk është lidhur ose disa çështje nuk janë rregulluar me

marrëveshjen ndërkombëtare, bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet në bazë të legjislacionit përkatës të Republikës së Kosovës.

## **KAPITULLI V**

### **ROLI I AGJENCISË NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE**

#### **Neni 16**

##### **Roli mbështetës i Agjencisë**

1. Agjencia, në përputhje me Kodin, ofron ndihmë profesionale dhe teknike për të gjitha organet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me qëllim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me sekuestrim apo konfiskim të pasurisë.
2. Sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit dhe Gjykatës, Agjencia ofron këshilla në lidhje me natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, dhe ofron mbështetje në planifikimin e sekuestrimit, apo konfiskimit të pasurive.
3. Në bazë të kërkesës nga organi kompetent, në rastet e përshtatshme, Agjencia mund të ofrojë mbështetje profesionale dhe teknike jashtë ambienteve të punës, duke ndihmuar në zhvendosjen fizike të pasurisë me qëllim të vendosjes së saj në posedim të Agjencisë.
4. Agjencia është e detyruar që në çdo kohë, t'ia mundësojë organit përgjegjës për ekzekutimin e vendimit gjyqësorë, dorëzimin fizik të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar në ambientet përkatëse të Agjencisë.
5. Në momentin e pranim dorëzimit të pasurisë në ambientet e Agjencisë hartohet procesverbali përkatës i pranim dorëzimit, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesi i Agjencisë që bën pranimin e pasurisë, si dhe nga personi përgjegjës që bën dorëzimin e pasurisë së tillë.

#### **Neni 17**

##### **Roli ekzekutues i Agjencisë**

1. Në momentin e pranimin të pasurisë, Agjencia bën ekzekutimin e plotë të të gjitha kërkesave të përcaktuara me vendimin përkatës të Gjykatës kompetente, të cilat përcaktojnë mënyrën e disponimit me pasurinë përkatëse të sekuestruar apo konfiskuar.
2. Në mungesë të kërkesave të qarta në vendimin e Gjykatës kompetente, Agjencia mund të kërkojë sqarime konkrete në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Me pranimin e pasurisë, Agjencia është përgjegjëse për ruajtjen, kontrollin dhe mbrojtjen e pasurisë, e cila është sekuestruar apo konfiskuar.
4. Shpenzimet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga paragrafi 1 i këtij neni, i bartë Agjencia.



## KAPITULLI VI ADMINISTRIMI ME PASURINË E SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR

### Neni 18

#### Administrimi me pasurinë e sekuestruar

1. Zyrtari i autorizuar i policisë që është përgjegjës për ekzekutimin e Urdhrit për sekuestrim është prezent në praninë dorëzimit të pasurisë së sekuestruar.
2. Agjencia ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim që të mirëmbajë dhe ruaj në mënyrë adekuate vlerën e pasurive.
3. Për pasurinë e paluajtshme të sekuestruar, Agjencia duhet t'a njoftojë organin kompetent për kryerjen e punëve të evidencës së paluajtshmërive, me qëllim të shënimit të barrës mbi këtë paluajtshmëri në evidencën përkatëse.
4. Agjencia administron letrat me vlerë (bonot e thesarit), në pajtim me ligjin i cili rregullon qarkullimin e letrave me vlerë. Agjencia shënon heqjen dhe tjetërsimin e pronësisë së këtyre letrave me vlerë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe mund të angazhojë pjesëmarrësin e autorizuar në tregun e letrave me vlerë, me qëllim të ndjekjes së lëvizjeve të tregut të këtyre letrave me vlerë të sekuestruara.
5. Agjencia bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar, i cili përmban po ashtu një alternativë për vlerën që pasuria e sekuestruar do të kishte në rast të shitjes së detyruar nga Agjencia. Alternativa për vlerën e shitjes së detyruar do të përfshijë po ashtu llogaritjen e të gjitha kostove dhe shpenzimeve që mund të bëhen nëse pasuria e sekuestruar do të shitej ose jo.
6. Agjencia duke u bazuar në analiza e veta do t'a këshilloj Gjykatën se a do të rezultonte një shitje e pasurisë apo jo në të ardhura përfituese ekonomike për Republikën e Kosovës. Nëse Agjencia vendosë që shitja e detyruar do të ishte joekonomike, i rekomandon gjykatës një, apo më shumë mundësi alternative të sistemit të pasurisë së sekuestruar ashtu siç lejohet me ligj.
7. Ruajtja e vlerës mund të sigurohet me mbajtjen, apo shitjen e pasurisë së sekuestruar nga ana e Agjencisë, në mënyrë që të zëvendësohet me një kundërvlerë monetare.
8. Në të gjitha rastet me pasuritë të cilat kërkojnë një administrim të veçantë të kompanive, bizneseve të veçanta, apo pasuri specifike për të cilat nevojiten njohuri të veçanta në fushën relevante, Agjencia angazhon administratorë të pavarur të fushës përkatëse me synim të administrimit efikas dhe funksionimit të mirë të kësaj prone.
9. Administratorët nga paragrafi 8 i këtij neni, përzgjidhen përmes shpalljes publike nga Agjencia. Me administratorin e përzgjedhur Agjencia lidhë kontratë, me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet reciproke dhe kushtet e shkëputjes së kontratës.
10. Në rastet e veçanta Agjencia mund të kërkoj nga gjykata që pasuria e sekuestruar t'i lihet për ruajtje, apo shfrytëzim personit të cilit i është sekuestruar pasuria.
11. Brenda dhjetë (10) ditëve të marrjes në administrim të pasurisë së sekuestruar, Agjencia informon gjykatën për pranimin e pasurisë dhe për lokacionin ku gjendet pasuria në ruajtje, për

kushtet e përgjithshme të pasurisë, specifikat dhe vlerën e pasurisë duke përfshirë një kopje të regjistrimit të pasurisë.

### **Neni 19**

#### **Administrimi me pasurinë e konfiskuar**

1. Pasuria dhe paratë e fituara me shitjen e pasurisë bëhen pronë e Republikës së Kosovës kur vendimi për konfiskim merr formën e prerë.

2. Në rastet kur Gjykata nxjerr një urdhër për konfiskim, për një pasuri e cila nuk është ende nën kontrollin e Agjencisë, zyrtari i policisë, përgjegjës për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës, do të jetë prezent gjatë pranimit dorëzimit të pasurisë së konfiskuar në Agjenci.

3. Me pranimin e pasurisë, Agjencia ruan dhe kontrollon pasurinë e cila është urdhëruar të konfiskohet dhe siguron mbrojtjen. Agjencia është autorizuar që të ndërmarrë masa të nevojshme për ruajtjen adekuatë dhe sigurimin e pasurisë së konfiskuar, si dhe të ruaj vlerën e pasurisë.

4. Agjencia mund të bëjë shitjen e sendeve ose dorëzimin e tyre për shfrytëzim nga Qeveria.

5. Brenda tridhjetë (30) ditëve të marrjes në administrim, Agjencia siguron vlerësimin teknik dhe financiar të pasurisë. Vlerësimi përmban një mendim për vlerën e tregut të pasurisë. Në përjashtim, në rastet e pasurisë unike (specifike), që mund të kërkojë afat më të gjatë, Agjencia mund të marrë mendimin e ekspertëve për vlerën e pasurisë.

6. Vlerësimi përmban po ashtu mendimin për vlerën e pasurisë së konfiskuar për shitje të detyruar nga Agjencia. Mendimi për vlerën e shitjes së detyruar do të përfshijë po ashtu llogaritjen e të gjitha kostove dhe shpenzimeve që mund të bëhen nëse pasuria e konfiskuar nuk do të shitet.

7. Agjencia duke u bazuar në analizat e veta, do të rezultonte që një shitje e pasurisë do të jetë, apo jo përfituese ekonomike për Republikën e Kosovës. Brenda tridhjetë (30) ditëve të pranimit të vlerësimit teknik dhe financiar, Agjencia do të vendoste në lidhje me sistemimin e pasurisë, e cila mund të përdoret nga shteti. Kur vendimi i konfiskimit merr formë të prerë, pasuria kalon në pronësi të shtetit në mënyrë të pakthyeshme. Në këtë rast, zotëruesi i tyre ka të drejtë të kërkojë zhdëmtimin e drejtë, nëse në vijim provohet paligjshmëria, apo pabazueshmëria e konfiskimit.

### **Neni 20**

#### **Pasuria jashtë Administrimit të Agjencisë**

1. Agjencia nuk administron me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar, e cila bie nën ndonjërin nga kategoritë në vijim:

1.1. substancat narkotike, substancat psikotropike, analoge apo veglat, pajisjet apo materialet narkotike;

1.2. armët, municionet apo materialet plasëse;

1.3. prodhimet alkooolike, të duhanit dhe prodhimet tjera për të cilat nuk ekziston deklarata doganore ose nëse janë falsifikuar;

1.4. pasuria tjetër, e cila nuk mund të shitet për shkak të sigurisë shëndetësore, veterinare, apo të sigurisë publike.

### **Neni 21**

#### **Vlerësimi i vlerës monetare të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar**

1. Me pranimin e pasurisë për nevoja të procedurës, Agjencia kryen vlerësimin e vlerës së pasurisë në raport me çmimin e saj të tregut në momentin e pranimin të pasurisë, duke shfrytëzuar shërbimet e vlerësuesve të punësuar në Agjenci ose vlerësuesit e licencuar të Republikës së Kosovës.
2. Vlerësuesit e licencuar nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilët janë të ftuar nëpërmjet shpalljes publike, me vlerësuesit e licencuar, Agjencia lidhë kontratë, me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet reciproke, si dhe kushtet e shkëputjes së kontratës.
3. Agjencia mund të kryej vlerësimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të sekuestruar për nevoja të dhënies me qira, dhënies në shfrytëzim pa kompensim, ose të shitjes të asaj pasurie.
4. Agjencia vlerëson pasuritë e pranuar sipas vlerës së saj aktuale të tregut në momentin e pranimin.

### **Neni 22**

#### **Veprimi me sendet me rëndësi historike dhe artistike**

1. Nëse janë sekuestruar sendet me vlerë të veçantë historike, shkencore apo artistike, Agjencia i dorëzon për ruajtje në institucionin përkatës kompetent për ruajtje të këtyre sendeve, deri në nxjerrjen e vendimit lidhur me kërkesën për konfiskim të pasurisë.
2. Pas marrjes së formës së prerë të vendimit me të cilën konfiskohen sendet nga paragrafi 1 i këtij neni, ato pa kompensim, i dorëzohen institucionit përkatës kompetent për ruajtje të këtyre llojeve të sendeve, të përcaktuara me ligj të veçantë.

### **Neni 23**

#### **Veprimi me paratë dhe sendet e çmuara të sekuestruara**

1. Paratë dhe sendet e çmueshme të sekuestruara, Agjencia i dorëzon për ruajtje në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, derisa vendimi të merr formën e prerë.
2. Sendet e konfiskuara nga paragrafi 1 i këtij neni, bëhen pronë publike dhe ruhen në mënyrën e përcaktuar me aktin e ministrisë kompetente për punët e financave.

### **Neni 24**

#### **Shpenzimet e ruajtjes dhe të mbajturit të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar**

1. Shpenzimet e ruajtjes dhe të mbajturit e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar i bartë Agjencia.
2. Mënyra e përcaktimit të shpenzimeve, të ruajtjes dhe të mbajturit e pasurisë së sekuestruar

dhe të konfiskuar, rregullohet me akt nënligjor të cilin e nxjerrë Ministri i Drejtësisë.

#### **Neni 25**

##### **Shkatërrimi i detyrueshëm i pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar**

1. Pasuria e sekuestruar dhe e konfiskuar, e cila duhet të shkatërrohet për shkak të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe të kafshëve, mbrojtjes së mjedisit, dhe për arsye tjera siguruese, shkatërrohet nën mbikëqyrjen e organeve kompetente, në pajtim me ligjin.
2. Vendimin përfundimtar për shpenzimet e shkatërrimit e nxjerrë Gjykata pas përfundimit të procedurës.
3. Shpenzimet e shkatërrimit të pasurisë, deri në nxjerrjen e vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni, i bartë Agjencia.

#### **Neni 26**

##### **Kthimi i pasurisë së sekuestruar**

1. Gjykata është e obliguar që Agjencisë t'ia dërgojë vendimin me të cilin pasuria e sekuestruar kthehet.
2. Pas pranimit të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës nga paragrafi 1 i këtij neni, Agjencioni, pa shtyrje, e më së voni në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të formës së prerë obligohet të kthejë pasurinë e sekuestruar.
3. Në rastet kur pasuritë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të kthehen, hartohet një procesverbal. Procesverbali për kthimin e pasurive duhet të përmbajë të dhëna në lidhje me pronarin e pasurisë, gjendjen e pasurisë në momentin e pranimit, vlerën e pasurisë, kohën e pranimit, mënyrën e ruajtjes dhe të dhëna tjera relevante.
4. Nëse pasuria e sekuestruar është shitur më herët, Agjencia duhet t'ia kthejë shumën e parave të siguruar nga shitja, të cilat në momentin e kthimit gjinden në llogarinë bankare në nenin 27 paragrafi 3 i këtij ligji.
5. Nëse pasuria është dhuruar apo është shkatërruar, pronari ka të drejtë të kompensohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

### **KAPITULLI VII**

#### **SHITJA E PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA**

#### **Neni 27**

##### **Shitja e pasurisë**

1. Me propozim të Agjencisë, Prokurori i shtetit, apo organi tjetër kompetent mund të kërkojë nga gjykata të vendosë për shitjen e një pasurie që mund ta humbë vlerën ose në rast të magazinimit të saj e tejkalon vlerën e saj, apo kur shpenzimet e magazinimit janë joproporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar. Pasuritë e tilla përfshijnë kafshët/bagëtitë, dhe pasuri të cilat e humbin shpejt vlerën e tyre.

2. Në rastet sipas paragrafit 1 të këtij neni, Agjencia mundet, pa ndonjë ankand publik, të shesë pasurinë e tillë përmes shpalljes publike ne web faqe të Agjencisë.
3. Të ardhurat nga shitja e pasurisë së sekuestruar derdhen në llogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Përndryshe, Agjencia e ruan pasurinë deri në momentin kur me anë të vendimit të Gjykatës urdhërohet konfiskimi. Agjencia mund t'a njoftojë Gjykatën për çfarëdo ndryshimi në lidhje me gjendjen e pasurisë apo vlerën e saj.
4. Mjetet në të holla nga shitja e pasurive të sekuestruara nga paragrafi 1 i këtij neni, mbahen në një llogari të veçantë të Agjencisë deri në momentin kur vendimi bëhet i formës së prerë.
5. Me qëllim të ruajtjes së vlerës së pasurive të sekuestruara, Agjencia mund të shesë pasurinë e luajtshme ose në mënyrë direkte ose përmes personit të caktuar fizik ose juridik.
6. Nëse pasuria e luajtshme nuk shitet gjatë dy (2) ankandëve publike, shitja mund të zbatohet përmes një marrëveshje direkte, në pajtim me ligjin.
7. Nëse shitja nuk rezulton të jetë e suksesshme me anë të marrëveshjes direkte ose nuk mund të shitet për një periudhë më të madhe se dy (2) vjet, pasuria e luajtshme e sekuestruar ose e konfiskuar mund të dhurohet për qëllime humanitare ose mund të shkatërrohet.
8. Mënyra dhe procedura e shitjes së pasurive të luajtshme të sekuestruara rregullohet me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë.
9. Shitja e letrave me vlerë kryhet në pajtim me dispozitat që rregullojnë qarkullimin e letrave me vlerë.
10. Nëse me këtë ligj nuk parashikohet ndryshe, për procedurën e shitjes së pasurive të konfiskuara zbatohen dispozitat e përshtatshme të ligjit, i cili rregullon procedurën e përmbarimit.
11. Me propozimin e Agjencisë dhe kërkesës së prokurorit, Gjykata mund t'i lejojë Agjencisë që në vend të shitjes së pasurisë së luajtshme të kërkojë nga pronari, apo personi tjetër të deponojë si një garanci bankare shumëmonetare të më së paku pesëdhjetë përqind (50 %) të vlerës monetare të pasurisë së njejtë. Pas depozitimit të garancisë, pasuria mund t'i dorëzohet depozit.

## **Neni 28**

### **Procedura pas shitjes**

1. Në momentin kur vendimi për konfiskim merr formën e prerë, pasuria dhe paratë e fituara me shitjen e pasurisë kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.
2. Pas shitjes së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar shuma e fituar e zëvendëson vlerën e pasurisë së shitur. Gjykata e cila ka marrë vendimin për shitje informohet nga Agjencia për rezultatin e shitjes.
3. Agjencia ka për obligim të administroj çdo shumë e cila fitohet nga shitja e pasurisë.
4. Të hyrat e realizuara nga shitja deponohen në xhirrollogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

## **KAPITULLI VIII DISPOZITA TË VEÇANTA MBI PASURITË E PALUAJTSHME**

### **Neni 29**

#### **Përdorimi i pasurive të paluajtshme dhe i atyre që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale**

1. Qeveria me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, përcakton kriteret, masën dhe mënyrën e përdorimit të pasurive të paluajtshme dhe të atyre që shërbejnë për veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale brenda kufijve të destinimit, të vendosura nga ky ligj.
2. Qeveria në nxjerrjen e këtij ligji, bazohet në parimet e miradministrimit të pronës, të rritjes së efektivitetit të drejtësisë penale, si dhe të rehabilitimit dhe zhdëmtimit të drejtë.

## **KAPITULLI IX DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 30**

#### **Vazhdimi i punës së Agjencisë**

1. Agjencia e cila është e themeluar në pajtim me Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar dhe personeli i saj vazhdon me punën në pajtim me këtë ligj.
2. Shitja e pasurisë dhe mjetet nga shitja e pasurisë, sipas legjislacionit aktual në fuqi, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen në pajtim me dispozitat përkatëse të këtij ligji për shitjen dhe mjetet nga shitja e pasurisë.
3. Procedurat e filluara me Ligjin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

### **Neni 31**

#### **Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, do të nxirren në afat prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 32**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji Nr. 03/L-141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 1/2010, për strukturën funksionale dhe organizative të Agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar.

**Neni 33**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-049**  
**24 mars 2016**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-008-2016, datë 05.04.2016 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga**

